



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

SHTOJCA A

PROGRAMI I TRANSPARENCËS
PËR
AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE

I. HYRJE

Në përputhje me nenin 7 të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, është përgatitur programi i transparencës i Autoritetit të Mediave Audiovizive. Ky program përcakton kornizën ligjore të veprimtarisë së autoritetit në kuadër të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” (LDI).

Ky program vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës AMA ndërton dhe rrit transparencën në punën e saj institucionale, nën garancinë e LDI-së. AMA angazhohet të përditësojë herë pas here Programin e Transparencës, në përputhje me pikën 2 të nenit 5 të LDI-së.

Informacioni i bërë publik në këtë program, synon të bëjë transparencën e veprimtarisë së punës së AP-së, nëpërmjet pasqyrit të detajuar të tij në faqen zyrtare www.ama.gov.al. Programi i transparencës pasqyrohet në rubrika, tekste/përmbajtje, afat kohor për bërjen publike të tij, mënyrën e bërjes publike si dhe strukturën përkatëse e cila prodhon ose administron dokumentin.

Në përmbajtje të programit të transparencës evidentohet skema e publikimit, e cila pasqyron menu-të ku adresohet dokumenti në faqen zyrtare në internet. Përveç kësaj, çdo dokument është i aksesueshëm edhe në skemë.

Dokumentacioni i bërë publik, do të jetë i përditësuar në formë e përmbajtje. Faqja zyrtare e AMA-s është ndërtuar në atë formë që mundëson informacion për publikun pa kërkesë në format lehtësisht të kuptueshëm. Në rubrikat e faqes zyrtare pasqyrohen edhe informacione që karakterizohen nga kufizime të identifikimit të të dhënave personale për shkak të ruajtjes së privatësisë së individëve/subjekteve të të dhënave, etj.

Skema e publikimit paraqitet nëpërmjet tabelës përmbledhëse të evidentuar në këtë program.

II. PARIME TË PËRGJITHSHME

Parimet kryesore në të cilat mbështetet Programi i Transparencës së AMA-s janë:

1. “E drejta për informim” është e drejtë Kushtetuese e parashikuar në nenin 23 të saj, e aksesueshme nga të gjithë pa asnjë përjashtim.
2. Prezumimi i publikimit maksimal të të dhënave: AMA ushtron funksione publike, për rrjedhojë informacioni që rrjedh nga veprimtaria e tij publikohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Zbatimi korrekt i ligjit dhe dispozitave ligjore që rregullojnë në mënyrë të posaçme veprimtarinë e AMA-s dhe përkatësisht: ligji nr. 97/2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë”. Gjithashtu zbatimi i ligjit për të drejtën e informimit, ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

dhe ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale (LMDHP) dhe ndikimet e tyre në veprimtarinë e këtij institucioni.

4. Informacioni përshtatet në gjuhë të qartë e të kuptueshme.
5. Organ mbikëqyrës i procedurave të informimit publik është Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale” (këtej e tutje KDIMDP).
6. Rishikimi i programit të transparencës bëhet sipas së njëjtës procedurë, përmes së cilës është bërë miratimi i tij. Miratim nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe me Urdhër të Inspektorit të Përgjithshëm.
7. Informacioni publik pa kërkesë duhet të jetë:
 - i plotë;
 - i saktë;
 - i përditësuar;
 - i thjeshtë në konsultim;
 - i kuptueshëm;
 - lehtësisht i aksesueshëm;
 - i pajtueshëm me dokumentet origjinale në posedim të autoritetit publik.

III. INFORMACIONI QË BËHET PUBLIK PA KËRKESË

Informacioni i lejuar për publikim është shprehimisht i parashikuar në nenin 7 të ligjit Nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”.

Në përputhje me këtë program transparence të miratuar, AMA vendos në dispozicion të publikut në faqen e saj të internetit www.ama.gov.al, kategoritë e mëposhtme të informacionit:

- Strukturën organizative të AMA-s;
- Tekstet e plota, të konventave që janë ratifikuar, të ligjeve, të akteve nënligjore, të kodeve të sjelljes, dokumente politikash, të manualit ose ndonjë dokument tjetër që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të tij dhe që prek publikun e gjerë;
- Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës;
- Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit;
- Të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime;
- Mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi AMA-n, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit;
- Të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit. Në ato raste kur autoriteti publik vetëfinancohet nga tarifat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

rregulluara prej tij, bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara;

- Informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006 “Për prokurimin publik”, që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë: listën e kontratave të lidhura, shumën e kontraktuar, palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara, informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme;
- Informacion për shërbimet që autoriteti i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit, një përshkrim të kategorive dhe formave të ndihmës shoqërore, subvencioneve të dhëna nga autoriteti publik dhe të procedurave për t’i përfituar ato, informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh, çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga autoriteti publik;
- Çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik, procedura, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të AP-së, një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë;
- AMA, gjithashtu, krijon dhe arkivon një kopje dixhitale të faqes zyrtare të tij në internet, të plotësuar me informacionin që kërkohet në programin e miratuar të transparencës, si dhe për metodat, mekanizmat dhe periodicitetin e publikimit të informacioneve publike, të cilat vihen në dispozicion të publikut pa kërkesë;
- Aktet që përmbajnë rregulla, norma apo kufizime të të drejtave dhe lirive themelore të individit, si dhe me efekt të drejtpërdrejtë për ta, bëhen publike me anë të afishimit apo postimit në faqen zyrtare të internetit, brenda 48 orëve prej miratimit të aktit nga AMA.

Informacioni i publikuar sipas kësaj skeme, përditësohet sa herë ai ndryshon.

IV. TABELA PËRMBLEDHËSE E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS SË AMA-S

Kategoritë e informacionit publik pa kërkesë	Baza ligjore	Dokumenti/Përmbajtja	Afati kohor për publikim	Mënyra e publikimit
Përshkrim i strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik.	Neni 7/1/a dhe 7/1/d	1. Vendimi i Kuvendit nr. 35/2015 2. Rregullorja e Brendshme e AMA-s (ne proces)	pas botimit në fletore zyrtare	WEB: AMA/struktura
Ligji Nr. 97/2013 “Për Mediat Audiovizive Në	Neni 7/1/ii		pas botimit në fletore zyrtare	WEB Tek rubrika



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

<i>Republikën E Shqipërisë</i>				Legjislacioni/Ligje
Ligje ndihmese: Ligji nr. 119/2014“Për të drejtën e Informimit”;	Neni 7/1/ii		pas botimit ne fletore zyrtare	WEB Tek rubrika Legjislacioni/Ligje
Ligji nr. 9131/2003 “Për Rregullat e Etikës në Administratën Publike”	Neni 7/1/ii			WEB Tek rubrika Legjislacioni/Ligje
Ligji nr. 10279/2010 “ Për kundërvajtjet administrative”;	Neni 7/1/ii			WEB Tek rubrika Legjislacioni/Ligje
Ligji nr. 152 /2013“Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar;	Neni 7/1/ii			WEB Tek rubrika Legjislacioni/Ligje
Ligji nr. 9902/2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”	Neni 7/1/ii			WEB Tek rubrika Legjislacioni/Ligje
Ligji nr. 8480/1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”;	Neni 7/1/ii			WEB Tek rubrika Legjislacioni/Ligje
Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”;	Neni 7/1/ii			WEB Tek rubrika Legjislacioni/Ligje
Ligji nr. 8485/1999“Kodi i Procedurave	Neni 7/1/ii			WEB Tek rubrika Legjislacioni/Ligje



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

<i>Administrative”, i ndryshuar;</i>				
Ligji nr. 9380/2005 “ <i>Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhurave me të”;</i>	Neni 7/1/ii			WEB Tek rubrika Legjislacioni/Ligje
Ligji nr. 9643, “ <i>Për prokurimin publik</i> ”	Neni 7/1/ii			WEB Tek rubrika Legjislacioni/Ligje
Directive 2010/13/Eu Of The European Parliament And Of The Council	Neni 7/1/b	Përafrimi i legjislacionit apo rregulloreve	pas botimit në fletore zyrtare	WEB Tek rubrika Legjislacioni/Ligje
Directive 2002/19/Ec Of The European Parliament And Of The Council	Neni 7/1/b	Përafrimi i legjislacionit apo rregulloreve	pas botimit në fletore zyrtare	WEB Tek rubrika Legjislacioni/Ligje
Directive 2002/21/Ec Of The European Parliament And Of The Council	Neni 7/1/b	Përafrimi i legjislacionit apo rregulloreve	pas botimit në fletore zyrtare	WEB Tek rubrika Legjislacioni/Ligje
Kodi Etik i Administratës Së Ama	Neni 7/1/b	Akte Nënligjore te Ligjit te AMA		WEB Legjislacioni/ Akte nënligjore te miratuara
Rregullore Mbi Procedurat E Rinovimit Të Licencave Të Operatorëve Privatë Audio Dhe Audiovizivë, Të Licencuar Sipas Ligjit Nr. 8410, Datë 30.09.1998 “Për Radion Dhe Televizionin Publik E Privat Në Republikën E Shqipërisë”, Të Ndryshuar	Neni 7/1/b	Akte Nënligjore te Ligjit te AMA		WEB Legjislacioni/ Akte nënligjore te miratuara
Kodi i Transmetimit Të Autoritetit Të Mediave Audiovizive	Neni 7/1/b	Akte Nënligjore te Ligjit te AMA		WEB Legjislacioni/ Akte nënligjore te miratuara



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Rregullore Për Licencimin E Rrjeteve Numerike Dhe Programeve Të Tyre, Nëpërmjet Procedurës Së Beauty Contest	Neni 7/1/b	Akte Nënligjore te Ligjit te AMA		WEB Legjislacioni/ Akte nënligjore te miratuara
Rregullore "Për Procedurat Dhe Kriteret E Dhënies Së Autorizimeve"	Neni 7/1/b	Akte Nënligjore te Ligjit te AMA		WEB Legjislacioni/ Akte nënligjore te miratuara
Rregullore "Mbi Procedurat E Inspektimit/Monitorimit Të Veprimtarisë Së Ofruesve Të Shërbimit Mediatik Audio Dhe/Ose Audioviziv"	Neni 7/1/b	Akte Nënligjore te Ligjit te AMA		WEB Legjislacioni/ Akte nënligjore te miratuara
Vendim Nr. 6, Datë 22.05.2013 "Mbi Miratimin E Pagesave Për Shërbimet Që Kryhen Nga Autoriteti I Mediave Audiovizive"	Neni 7/1/b	Akte Nënligjore te Ligjit te AMA		WEB Legjislacioni/ Akte nënligjore te miratuara
Vendim Nr. 5, Datë 22.05.2013 "Mbi Miratimin E Pagesave Për Autorizim"	Neni 7/1/b	Akte Nënligjore te Ligjit te AMA		WEB Legjislacioni/ Akte nënligjore te miratuara
Vendim Nr. 4, Datë 22.05.2013 "Mbi Miratimin E Pagesave Për Licencë"	Neni 7/1/b	Akte Nënligjore te Ligjit te AMA		WEB Legjislacioni Akte nënligjore te miratuara
Vendim Nr. 57 Datë 10.07.2015 Për Një Shtesë Në Vendimin E Ama-S Nr. 5, Datë 22.05.2013 "Mbi Miratimin E Pagesave Për Autorizim"	Neni 7/1/b	Akte Nënligjore te Ligjit te AMA		WEB Legjislacioni/ Akte nënligjore te miratuara
Rregullore "Për transmetimin pa shpërblim të mesazheve me interes të lartë për publikun e gjerë".	Neni 7/1/b	Akte Nënligjore te Ligjit te AMA		WEB Legjislacioni/ Akte nënligjore ne proces miratimi
Rregullore "Mbi	Neni 7/1/b	Akte Nënligjore te		WEB



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

<i>procedurat e inspektimit të veprimtarisë së ofruesve të shërbimit mediatik audio dhe/ose audioviziv</i>		Ligjit të AMA		Legjislacioni/ Akte nënligjore ne proces miratimi
<i>Projekt-rregullore “Për komunikimet audio dhe/ose audiovizive me natyrë tregtare dhe reklamat. Format, kushtet dhe koha ditore e lejuar për transmetimin e reklamave”.</i>	Neni 7/1/b	Akte Nënligjore të Ligjit të AMA		WEB Legjislacioni/ Akte nënligjore ne proces hartimi
<i>Projekt-rregullore “Për planin e renditjes së shërbimeve mediatike audiovizive që mbështeten në rrjete numerike”.</i>	Neni 7/1/b	Akte Nënligjore të Ligjit të AMA		WEB Legjislacioni/ Akte nënligjore ne proces hartimi
<i>Projekt-rregullore “Mbi ofrimin e shërbimeve me akses të kushtëzuar”</i>	Neni 7/1/b	Akte Nënligjore të Ligjit të AMA		WEB Legjislacioni/ Akte nënligjore ne proces hartimi
<i>Projekt-rregullore “Për dhënien e licencave të transmetimit audio për qëllime të përkohshme dhe nevoja institucionale”</i>	Neni 7/1/b	Akte Nënligjore të Ligjit të AMA		WEB Legjislacioni Akte nënligjore ne proces hartimi
<i>Projekt-rregullore “Për procedurat dhe kriteret për dhënien e licencës së transmetimit audio”</i>	Neni 7/1/b	Akte Nënligjore të Ligjit të AMA		WEB Legjislacioni/ Akte nënligjore ne proces hartimi
<i>Projekt-rregullore “Për përcaktimin ngjarjeve me rëndësi të madhe dhe mënyrën e transmetimit të tyre dhe të drejtën e raportimit të lajmeve të shkurtra”.</i>	Neni 7/1/b	Akte Nënligjore të Ligjit të AMA		WEB Legjislacioni/ Akte nënligjore ne proces hartimi
<i>Projekt-udhëzim “Për format dhe kategoritë e programeve për regjistrim dhe arkivim”.</i>	Neni 7/1/b	Akte Nënligjore të Ligjit të AMA		WEB Legjislacioni/ Akte nënligjore ne proces hartimi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Projekt-rregullore “Për procedurat dhe kriteret për dhënien e licencës së transmetimit audioviziv dhe licencës së shërbimit të programit audioviziv”.	Neni 7/1/b	Akte Nënligjore te Ligjit te AMA		WEB Legjislacioni/ Akte nënligjore ne proces hartimi
Projekt-rregullore “Mbi procedurat e rinovimit të licencave të transmetimit audio”.	Neni 7/1/b	Akte Nënligjore te Ligjit te AMA		WEB Legjislacioni Akte nënligjore ne proces hartimi
Projekt-rregullore “Për monitorimin e spektrit të frekuencave”.	Neni 7/1/b	Akte Nënligjore te Ligjit te AMA		WEB Legjislacioni Akte nënligjore ne proces hartimi
Projekt-rregullore “Për kriteret dhe masat rregulluese për bashkëpërdorimin e infrastrukturës së transmetimit të RTSH-së	Neni 7/1/b	Akte Nënligjore te Ligjit te AMA		WEB Legjislacioni Akte nënligjore ne proces hartimi
Projekt-rregullore “Për dhënien e licencave të transmetimit audio të komunitetit”	Neni 7/1/b	Akte Nënligjore te Ligjit te AMA		WEB Legjislacioni Akte nënligjore ne proces hartimi
Vendime te miratuara nga Këshilli i AMA	Neni 7/1/b	Akte Nënligjore te Ligjit te AMA	Miratuar me Vendim Bordi	WEB Legjislacioni/ Vendime
Strategjia për kalimin nga transmetimet analoge në transmetimet numerike	Neni 7/1/b		Miratuar me vkm nr. 292 date 02.05.2012	WEB Digjitalizimi/ Kuari Ligjor
Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për	Neni 7/1/c dhe 7/1/g	Format kërkesë Format përgjigje Format ankese Format për refuzim kërkesë	Miratuar nga Komisioneri DI	WEB Rubrika Veprimtar/transparenca



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës.		Format për zgjatje afati Format për rishikimin e dokumenteve të klasifikuara dhe shtyrjen e afatit Adresë postare Adresë e-maili		
Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit.	Neni7/1/ç	Rr. Abdi Toptani, ish hotel Drini, kati i 4, 1001 Tiranë. Shiko më poshtë*		WEB Kontakto AMA
Përshkrim i procedurave të zgjedhjes, kompetencave të funksionarëve të lartë;	Neni 7/1/d	Vendim Kuvendi Parashikimet ligjore: a) Nenet 7-14, të ligjit nr. 97/13 "Për Mediat Audiovizive" në Republikën e Shqipërisë	Pas botimit në fletore zyrtare	WEB Ne rubrikën Legjislacion janë cituar Ligjet përkatëse që shpjegojnë këto procedura
Procedura e ndjekjes për marrjen e vendimeve		Rregullore për funksionimin dhe mbajtjen e procesverbalit të mbledhjes së bordit, miratuar me vendim nr.520, datë 06.11.2006 të AMA-s		WEB Legjislacioni/ Vendime
Mekanizmat monitorues; raporte audit; dokumentet me tregues performance	Neni7/1/dh	1. Raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit	Menjëherë pas miratimit të aktit nga institucioni përkatës dhe	WEB Ne rubrikën AMA/ "Buxhet dhe Auditim"



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

			marrja e tij nga AMA.	
Raportet vjetore të AMA-s				WEB Rubrika AMA/Raport Vjetor
Buxheti	Neni 7/1/e	Buxheti	Menjëherë pas miratimit të aktit nga Autoriteti me vendimin nr. 15 date 17.12.2014	WEB Ne rubrikën AMA/ "Buxhet dhe Auditim"
Informacion për procedurat e prokurimit.	Neni 7/1/ë	1. Ligji nr. 9643, "Për prokurimin publik" 2. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914 date 29.12.2014 "Për miratimin e rregulloreve të prokurimit publik"		WEB Legjislacion/Ligje
Formulari për për ankesat dhe kërkesat nga OSHMA	Neni 7/1/f	Trajtim i ankesave/kërkesave të Subjekteve		WEB Transparenca
Formular për ankesat dhe kërkesat për përmbajtjet e transmetimeve audiovizive	Neni 7/1/f	Trajtim i ankesave/kërkesave të Subjekteve		WEB Transparenca
Nxjerrja e çdo projekt-akti për konsultim publik	Neni 7/1/gj	Projekt akte	Pas përfundimit të hartimit të p/aktit	WEB Këshillim Publik (ne balline)
Mbajtja e dokumentacionit nga Arkiv Protokolli	Neni 7/1/h	Ligji për arkivat Protokoll /Arkiva		WEB Rubrika Veprimtari/Transparenca
Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të këtij ligjit nr.119/2014.	Neni 7/1/i			WEB Rubrika Veprimtari/ Transparenca
Informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh.	Neni 7/1/k	Kuadri ligjor	Menjëherë pas miratimit të aktit	WEB Legjislacioni



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

		Të dhëna për subjektet audiovizive		WEB Mediat
Informacione të tjera të dobishme	Neni 7/1/l	Historiku, misioni, objektivat		WEB AMA / Rreth AMA-s
Njoftime	Neni 7/1/l			
Këshillimi publik	Neni 7/1/l			
Kontakte	Neni 7/1/l			
Bashkëpunime	Neni 7/1/l			
Deklarata	Neni 7/1/l			
Konferenca	Neni 7/1/l			

***Informacioni që bëhet publik pa kërkesë. Mënyrat e publikimit të tij.**

Informacioni i lejuar për publikim është shprehimisht i parashikuar në ligjin për të drejtën e informimit, konkretisht në Nenin 7 të LDI.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Në përputhje me këtë program transparence të miratuar, AMA vë në dispozicion të publikut në faqen e saj të internetit www.ama.gov.al, kategoritë e mëposhtme të informacionit:

- **Organigramën e AMA-s;**

1. Vendimi nr. 35/2015 “Për disa ndryshime në strukturën, organikën dhe kategorizimin e pozicioneve të punës të Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA).

- Tekstet e plota të konventave që janë ratifikuar, të ligjeve, të akteve nënligjore, të kodeve të sjelljes, dokumente politikash, të manualit ose ndonjë dokument tjetër që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të tij dhe që prek publikun e gjerë:

- a. **Ligje mbi funksionimin dhe organizimin e veprimtarisë së Autoritetit të Mediave Audiovizive:**

Ligji nr. 97/2013 “Për Mediat Audiovizive” në Republikën e Shqipërisë

- b. **Ligje të tjera ndihmëse**

1. Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit”;
2. Ligji nr. 9131/2003 “Për Rregullat e Etikës në Administratën Publike”;
3. Ligji nr. 152 /2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar;
4. Ligji nr. 8485/1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, i ndryshuar;
5. Ligji nr. 9380/2005 “ Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhurave të ”;
6. Ligji nr. 8480/1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”;
7. Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”;
8. Ligji nr. 9902/2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”;
9. Ligji nr. 10279/2010 “ Për kundërvajtjet administrative”;

- c. **Aktet nënligjore**

Kodi i Transmetimit të Autoritetit të Mediave Audiovizive

Kodi Etik i Administratës së AMA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Rregullore mbi procedurat e rinovimit të licencave të operatorëve privatë audio dhe audiovizivë, të licencuar sipas ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998 “Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar

Rregullore për licencimin e rrjeteve numerike dhe programeve të tyre, nëpërmjet procedurës së Beauty Contest.

Rregullore “Për procedurat dhe kriteret e dhënies së autorizimeve”

Rregullorja “Mbi procedurat e inspektimit/monitorimit të veprimtarisë së ofruesve të shërbimit mediatic audio dhe /ose audioviziv.

Vendim “Mbi miratimin e pagesave për shërbimet që kryhen nga AMA”.

Vendim “Mbi miratimin e pagesave për autorizim”.

Vendim “Mbi miratimin e pagesave për licencë”.

Vendim “Për një shtesë në vendimin e ama-s nr. 5, datë 22.05.2013 “Mbi miratimin e pagesave për autorizim””

Vendim “Mbi miratimin e projektbuxhetit për vitin 2016”

Vendim “Për disa ndryshime në projektbuxhetin e vitit 2015”

d. Dokumente politikash

- Strategjia për kalimet nga transmetimet analoge në transmetime numerike

Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës; (shiko më poshtë)

- [Format kërkesë](#)

Email: info@ama.gov.al

Rr. Abdi Toptani, ish Hotel Drini kati i 4

- **Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të AMA-s:**

Rr. Abdi Toptani, ish Hotel Drini, kati i 4, 1001 Tiranë,

- **Orari zyrtar i punës:**

E hënë - e enjte Ora: 8:00-16:30



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

E premte ora: 8:00-14:00 (e shtunë dhe e ë pushim)

/ Përveç festave zyrtare

Ditët e festave për vitin 2015

1 & 2 Janar - Festat e Vitit të Ri
14 Mars - Dita e Verës
22 Mars - Dita e Nevruzit
27 Mars - Dita e Pashkës Katolike
1 Maj - Dita e Pashkës Ortodokse; Dita Ndërkombëtare e Punonjësve
5 Korrik - Dita e Bajramit të Madh
12 Shtator - Dita e Bajramit të Vogël
19 Tetor - Dita e Lumturimit të Nënë Terezës
28 Nëntor - Dita e Flamurit dhe e Pavarësisë
29 Nëntor - Dita e Çlirimit
08 Dhjetor - Dita Kombëtare e Rinisë
25 Dhjetor - Dita e Krishtlindjeve

- **Emrin dhe kontaktet e koordinorit për të drejtën e informimit; (Neni 2 i LDI- Koordinatori është nëpunës civil, përcaktuar në nenin 10 të LDI)**

Znj. Alma Dervishaj alma.dervishaj@ama.gov.al dhe

Znj. Fjoralba Murati fjoralba.murati@ama.gov.al

- **Informacion dhe kontakte me AMA-n:**

Tel: +355 4 222 6288

Cel: 066 20 44 909

E-mail: info@ama.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

- **Të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit dhe strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë,**
 1. Vendimi nr. 35/2015 “Për disa ndryshime në strukturën, organikën dhe kategorizimin e pozicioneve të punës të Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA),
 2. Rregullorja e AMA-s (shiko aktet nënligjore).
- **Përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime;**

Ligji nr. 97/2013 “Për Mediat Audiovizive” në Republikën e Shqipërisë

Ligji nr. 8480/1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”.

- **Mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi AMA-n:**
 1. Raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit.
- **Të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit.**

Raportet vjetore

- **Informacion për procedurat e prokurimit publik**
 1. Lista e kontratave të lidhura, shumën e kontraktuar, palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara, informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme;
 2. Ligji nr. 9643, datë 20.12.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914 date 29.12.2014 “Për miratimin e rregulloreve të prokurimit publik”

- **Informacion për shërbimet apo informacionin që AMA jep në faqen e saj të internetit:**

1. Misioni dhe qëllimi i krijimit të institucionit;
2. Bordi, Struktura organizate e AMA-s, Këshilli i Ankesave, Drejtoritë, Punësimet;
3. Njoftime për shtyp mbi veprimtarinë e AMA-s:
 - a. Takime dhe vizita pune me institucione vendase dhe të huaja
 - b. Marrëveshje Bashkëpunimi të lidhura (Kopje të tyre)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

c. Njoftime vendimesh të Bordit

Të dhënat që do të mbahen në regjistrin për të drejtën e informacionit të AMA-s.

AMA administron të dhëna që janë në kompetencë të saj dhe që kanë të bëjnë me deklarin e pasurive dhe konfliktin e interesave dhe i vendos ato në dispozicion të kërkuësve me kërkesë, konform rregullave të përcaktuara në ligj. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka vendosur standarde për formatin dhe përmbajtjen e regjistrit, konkretisht në përputhje me elementët që përcaktohen në LDI. Regjistri për të drejtën e informacionit në AMA përmban këto të dhëna:

- 1- Numri rendor i kërkesës;
- 2- Data e regjistrimit të kërkesës;
- 3- Objektin e kërkesës;
- 4- Data e kthimit të përgjigjes;
- 5- Statusi i kërkesës (pranuar/refuzuar);
- 6- Tarifa (me pagesë/pa pagesë).

- **Informacioni që bëhet publik me kërkesë. Mënyrat e publikimit të tij.**

Autoriteti i Mediave Audiovizive ka të drejtë të kufizojë të drejtën për informim vetëm në rastet e parashikuara në nenin 17 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

- **E Drejta për informim dhe Procedura.**
- **Kërkesa për informim:**

Kërkesa e palës së interesuar për informacion, bëhet me shkrim dhe dërgohet dorazi, me postë ose me postë elektronike, duke paraqitur qartë identitetin e kërkuësit dhe nënshkrimin e tij. Në çdo rast, kur kërkesa dorëzohet dorazi apo nëpërmjet shërbimit postar, duhet të përmbajë elementët e përcaktuar në pikën 4 të nenit 11 të LDI, ku përfshihen: emri dhe mbiemri i kërkuësit; adresa postare ose elektronike ku kërkohet të dërgohet informacioni; përshkrimi i informacionit që kërkohet; formati në të cilin preferohet informacioni; dhe çdo e dhënë që kërkuësi gjykon se mund të ndihmojë në identifikimin e informacionit të kërkuar.

- **Konstatimi i kompetencës ose moskompetencës së AMA-s:**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Të gjitha kërkesat për informacion trajtohen si rregull, nëpërmjet dhënies pa pagesë të informacionit nga AMA, apo nëpërmjet informacionit të ofruar në faqen zyrtare të internetit: www.ama.gov.al

Çështja e përcaktimit të kompetencës për trajtimin e kërkesës varet nga:

1. Objekti i kërkesës;
2. Natyra e të dhënave që kërkohen;
3. Mundësia e AMA-s për ta përpunuar apo interpretuar kërkesën;
4. Përcaktimi konkret i departamentit kompetent për të;
5. Vendndodhja fizikisht e dokumentit që përmban këtë informacion.

- **Përgjigjet dhe Vendimet e AMA-s**

Përgjigjet dërgohen me postë ose merren dorazi brenda afatit 10 ditor të përcaktuar në LDI. Për shkaqe të përcaktuara, AMA rezervon të drejtën të zgjasë me vendim afatin e dhënies së informacionit, në përputhje me legjislacionin në fuqi me 5 (pesë) ditë.

- **Ankimet**

Çdo person, kur çmon se i janë shkelur të drejtat e parashikuara nga ky ligj, ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP), në përputhje me këtë ligj dhe Kodin e Procedurave Administrative. Ankimi administrativ pranë KDIMDP-së, bëhet brenda 30 ditëve pune nga dita kur:

- a) ankuesi ka marrë njoftim për refuzimin e informacionit;
- b) ka kaluar afati i parashikuar në këtë ligj për dhënien e informacionit.

Programi i transparencës së AMA-s si dhe skema e publikimit hyjnë në fuqi menjëherë.

V. PUBLIKIMI

Në përputhje me këtë program transparence të miratuar, AMA vendos në dispozicion të publikut në faqen e saj të internetit www.ama.gov.al, kategoritë e mësipërme, në një menu të veçantë të titulluar “Programi i Transparencës”.

VI. MONITORIMI

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale monitoron zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit, duke nxitur parimin e transparencës në punën e autoriteteve publike, veçanërisht duke sensibilizuar dhe informuar për çështje të së drejtës së informimit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Komisioneri bën rekomandime për autoritetet publike, duke përfshirë dhe AMA-n, lidhur me konceptimin dhe zbatimin e programeve institucionale të transparencës.